



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*



MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

## AAAPARr - mundësi për përfitim të shkathtësive të avancuara sipas standardeve evropiane (Pasqyrë e punës e AAAPARr-së gjatë vitit 2023)



---

Përgatitur për botim nga:

Stafi i AAAPARr-së

Botues:

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr)

Ndërtesa: MAShTI II, pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik, kati III

Rr. “Agim Ramadani”, p. n., Prishtinë

## **Përmbajtja**

Përmbajtja.....	3
<b>Fjalimi i drejtoreshës.....</b>	<b>5</b>
<b>Konferenca V e AAAPARR-së “Cilësia në AAP - atraktivitet në tregun e punës” .....</b>	<b>8</b>
<b>Ceremonia e diplomimit për “Këshilltar për karrierë”, niveli i 5-të i kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.....</b>	<b>9</b>
Ofrimi i kualifikimit të nivelit të pestë për “Këshilltar për karrierë” .....	9
Certifikohen 15 këshilltarët e parë të karrierës të nivelit të pestë.....	10
<b>Zhvillimi dhe ofrimi i arsimit dual.....</b>	<b>11</b>
Implementimi i mësimet dual në drejtime të ndryshme në qendrat e kompetencës.....	12
<b>Konferenca për arsim për të rritur.....</b>	<b>13</b>
<b>Punëtorja e organizuar nga AAAPARR dhe DVV International .....</b>	<b>15</b>
<b>Ofrimi i kualifikimit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta” .....</b>	<b>16</b>
<b>Rekrutimi i kandidatëve në kualifikimin e nivelit të pestë AFNVA .....</b>	<b>17</b>
Diplomimi i gjeneratë së katërt të asistentëve për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore .....	17
<b>Zhvillimi dhe ofrimi i kurseve afatshkurtra modulare .....</b>	<b>18</b>
<b>Nënshkrimi i marrëveshjes me OJQ-në “KOSHA” për realizimin e trajnimit për siguri dhe shëndet në qendrat e kompetencës.....</b>	<b>19</b>
<b>Nënshkrimi i marrëveshjes me “Yllirian Sh. P. K.” për zbatimin e platformës së e-shkollorit në shkollat partnere të AAAPARR-së .....</b>	<b>21</b>
<b>Dyert e hapura në qendrat e kompetencës .....</b>	<b>22</b>
<b>Vizitat, konferencat dhe takimet jashtë vendit .....</b>	<b>23</b>
Lëvizshmëria e nxënësve në Itali në kuadër të projektit “MOVET” .....	23
Lëvizshmëria e nxënësve në Bruksel.....	25
<b>Vizitë në Malta.....</b>	<b>28</b>
<b>Vizitë pune në Shqipëri.....</b>	<b>30</b>
<b>Punëtorja në Shqipëri me MASHTI-n.....</b>	<b>31</b>

.....	31
<b>Pjesëmarrja në simpoziumin e EVTA-s në Selanik- Greqi .....</b>	<b>31</b>
<b>Vizitat/takimet e realizuara nga agjencia për arsim dhe aftësim profesional dhe arsim për të rritur, në bashkëpunim me Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGjK) në qendrat e kompetencës .....</b>	<b>32</b>
<b>Konferenca me EVBB (Shoqata Evropiane e Insiteve për Aftësimin Profesional me seli në Bruksel) për “Erasmus+ Mundësitë për Kosovën për t’i përmirësuar njohuritë, shathtësitë dhe kompetencat në fushën e AAP-së” .....</b>	<b>34</b>
<b>WEBINARET- Takimet online .....</b>	<b>35</b>
“Tejkalimi i pengesave për të rinjtë në mësimin e bazuar në punë dhe praktikatat jashtë vendit: Praktikatat premtuese nga ALMA dhe Erasmus” .....	35
“Puna lidhur me adresimin e sfidave në fushën e kompetencave dixhitale (Digicomp) Hack4Society "Hackathon" .....	35
“Zhvillimi i shkathtësive digjitale: Drejt iniciativave të matshme dhe të qëndrueshme”.....	37
<i>Webinar: “Udhëzues për Programin Erasmus+ 2024 dhe Thirrje për Propozime” .....</i>	<i>38</i>
“Aktivitetet e të mësuarit nga bashkëmohatarët e organizuar nga EVBB në kuadër të grantit operacional META VET” .....	39
<b>1. SEKTORI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE .....</b>	<b>40</b>
<i>1.1. Qeverisja dhe legjislacioni .....</i>	<i>40</i>
<i>1.1.1. Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Burimeve Njerëzore.....</i>	<i>40</i>
<i>1.1.2. Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Financave .....</i>	<i>42</i>



*Fikrije Zymberi*

*u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së*

## **Fjala e drejtoreshës**

Secilit qytetar duhet t'i ofrohet mundësia për arsim dhe aftësim profesional dhe arsim për të rritur si dhe arsim gjatë gjithë jetës, cilësor dhe i orientuar kah kërkesat e tregut të punës që ka për qëllim rritjen e punësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Arsimi profesional dhe arsimi për të rritur ballafaqohen me sfida të shumta që ndërlidhen me fusha të tjera, sikurse me sektorin privat, i cili do të duhej të jetë i gatshëm dhe më shumë kompetent për të bashkëpunuar për ngritjen e cilësisë në arsimin profesional.

Mundësitë për trajnimin praktik të nxënësve në shkollë, mësim në vendin e punës dhe zbatim të sistemit dual, ndonëse janë në nivel më mirë se më parë, sidomos tani me zbatimin e mësimin dual në disa profile, ende mbeten të kufizuara, të cilat ndikojnë padyshim në cilësinë e arsimit profesional.

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur ka për qëllim mbikëqyrjen dhe zhvillimin e arsimit dhe aftësimin profesional dhe për të rritur për të gjitha IAAP-të, por ende vazhdon të funksionojë vetëm me menaxhimin e gjashtë qendrave të kompetencës dhe mbetet indikator e vogël matëse e cilësisë për tërë sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional në Republikën e Kosovës.

Lidhja e arsimit me tregun e punës realizohet më mirë me zbatimin e konceptit të arsimit dual, duke i trajnuar nxënësit drejtpërdrejt në vendin e punës, dhe kjo mundëson përgatitjen më të mirë të tyre me shkathtësi praktike, nga ana tjetër kompanitë marrin fuqi punëtore potenciale të gatshme për përfshirje në proceset e punës menjëherë pas diplomimit.

AAAPARr ka nevojë të plotësohet me kapacitete të mjaftueshme për të siguruar që:

- të jetë institucion udhëheqës për AAP-në në Kosovë, për të siguruar cilësi dhe qëndrueshmëri për t'i realizuar objektivat e Kosovës për progres ekonomik dhe social,
- ta fuqizojë komponentin e saj të planifikimit strategjik,
- të organizojë hulumtime mbi kërkesat e tregut të punës që do t'u shërbenin IAAP-ve për të ofruar AAP në pajtueshmëri me kërkesat ekonomike dhe ta rrisë punësimin e të rinjve,
- të koordinojë dhe monitorojë procesin e zhvillimit të standardeve të profesionit,
- ta udhëheqë procesin e zhvillimit të kurrikulave dhe kualifikimeve të AAP-së,
- ta ndihmojë menaxhmentin e shkollave dhe bordet drejtuese të tyre për ta menaxhuar vetë institucionin për sa iu përket financave, personelit dhe infrastrukturës,
- të jetë promotor i zhvillimit të kapaciteteve të IAAP-ve,
- të ofrojë ekspertizë dhe ta udhëheqë procesin e trajnimit të mësimitdhënësve për zhvillim profesional të vazhdueshëm dhe zbatim të kurrikulave, zhvillim të materialeve mësimore dhe atyre mbështetëse,
- ta mbikëqyrë zbatimin e politikave në IAAP, t'i monitorojë standardet e mësimitdhënies,
- të ofrojë mbështetje përmes ekspertizës specifike profesionale për IAAP-të,
- të iniciojë dhe të ofrojë bashkëpunim për zhvillimin e programeve dhe projekteve për IAAP,
- t'i mbështesë analizat, hulumtimet dhe planet zhvillimore për IAAP-të për lidhje sa më të mirë me tregun e punës,

- ta këshillojë MASHT-in për rishikimin dhe zhvillimin e legjislacionit të AAPARr-së,
- ta mbështesë sistemin e udhëzimeve në karrierë dhe të përcjelljes së sapo të diplomuarve në IAAP,
- të themelojë dhe ndërtojë një sistem informativ me bazë të të dhënave për sa iu përket infrastrukturës, laboratorëve, pajisjeve, nxënësve, stafit, kushteve materiale, pasurisë dhe informatave të tjera të domosdoshme sipas veprimtarisë së IAAP-së.

Qendrat e Kompetencës kanë për qëllim të ofrojnë punëtorë të kualifikuar me njohuri dhe shkathtësi praktike që u përgjigjen nevojave të tregut të punës në Kosovë dhe BE. Krijimi i kuadrove profesionale dhe kompetente sipas kërkesave të tregut të punës do të ndikojë dukshëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

Përveç programeve të rregullta trevjeçare, në sistemin formal të arsimit në Kosovë vazhdon t'i zbatohet programet e nivelit të pestë të kualifikimit. Këto arritje janë storie të suksesit, shënuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe me mbështetjen e donatorëve, gjithashtu.

Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet AAP-së dhe biznesit është i pashmangshëm kur bëhet fjalë për përcaktimin e kërkesave dhe drejtimeve të kualifikimeve. Zhvillimi ekonomik mund të arrihet nëpërmjet arsimit profesional dhe të sigurojë mirëqenie për Kosovën. Biznesi është ai që mund ta vlerësojë më mirë se kushdo tjetër, se cilat kërkesa janë të domosdoshme për ushtrimin e cilit profesion dhe në cilat kushte.

## Konferenca V e AAPARR-së “Cilësia në AAP - atraktivitet në tregun e punës”

Konferenca V e AAPARR-së “Cilësia në AAP - atraktivitet në tregun e punës”.

Është mbajtur konferenca e pestë vjetore e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur. Mes të ftuarve nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare u prezantuan të arriturat e Agjencisë gjatë vitit 2023, të cilat janë të arritura domethënëse që ndikojnë në përmirësimin e arsimit dhe aftësimin profesional dhe ngritjen e cilësisë në shkollat profesionale. Gjithashtu, u diskutua edhe për sfidat të cilat janë të shumta dhe për mundësitë që së bashku me përkushtim dhe vizion të bëhen zgjidhje cilësore.

Me prani dhe paraqitje domethënëse konferencën e pasuruan panelistët dhe prezantuesit e institucioneve udhëheqëse relevante.





## **Disa nga rekomandimet e nxjerra nga konferenca:**

Organizata GIZ inkurajohet ta vazhdojë bashkëpunimin me MASHTI-n për hartimin e kornizës kurrikulare për përmbajtje më të gjerë të elementeve të mësimit praktik, me më shumë module praktike në arsimin profesional, si dhe të punojë në skenarë të ndryshëm për ta bërë ma efikase strategjinë e punësimit, digjitalizimin dhe orientimin në karrierë, për ta bërë AAP më efikase me skenarë të ndryshëm.

Kurrikulat për AAP të zhvillohen nga bizneset dhe të krijohet baza ligjore, sepse bizneset në Kosovë nuk kanë fare kurrikula të zhvilluara. Të zgjatet afati trevjeçar për aftësim të nxënësve në kompani, pra të ketë një segment shtesë për zhvillimin e mësimi dual për nxënës.

Kurrikulat për AAP të harmonizohen në baza vjetore me tregun e punës. Të ketë më shumë mjete të konkretizimit. Të hartohet literaturë profesionale/adekuate, pastaj të ketë mësimdhënës kompetentë për profile, me përvojë teknike/praktike.

Sfidë momentale në vendin tonë është largimi i të rinjve nga vendi. Andaj mund të bëhet më shumë edhe nga ana e shkollave dhe akterëve të tjerë institucionalë në këtë drejtim, duke krijuar kushte, veprime konkrete, të qenit më kreativë dhe futja e shpirtit të ndërmarrësisë tek të rinjë në mënyrë që të frenohet kjo dukuri.

## **Ceremonia e diplomimit për “Këshilltar në karrierë”, niveli i pestë i kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve**

### **Ofrimi i kualifikimit të nivelit të pestë për “Këshilltar për karrierë”**

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve në komponentin e orientimit në karrierë në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional ka vazhduar ofrimi i programit kualifikues për certifikimin e këshilltarëve të karrierës në Qendrën e Kompetencës në Prizren, si qendër e akredituar për ofrimin e këtij kualifikimi, të cilët do të punojnë në qendrat e karrierës. Qendrat e karrierës me bazë në shkolla profesionale, së bashku me këshilltarët e karrierës, luajnë rol shumë të rëndësishëm në orientimin e nxënësve për përzgjedhjen e profesionit, informimin, këshillimin

dhe trajnimin e tyre, për t'u përgatitur për tregun e punës.

## **Certifikohen 15 këshilltarët e parë të karrierës të nivelit të pestë**



Është mbajtur ceremonia e certifikimit të këshilltarëve të parë të karrierës përmes programit kualifikues të akredituar të nivelit të pestë, roli dhe funksioni i të cilëve është esencial për të ofruar shërbime cilësore për ngritjen e vetëdijes së nxënësve për përzgjedhjen e profesionit dhe për orientimin e tyre në karrierë.

Këshilltarët për karrierë ofrojnë shërbime për nxënësit që të kenë informacione për shkolla profesionale dhe nevojat e tregut të punës, çfarë lloje profilesh ofrojnë ato, për kohëzgjatjen e shkollimit, për realizimin e mësimit praktik në ndërmarrje, mundësinë e punësimit, shkathtësi të buta që ata të orientohen me kompetenca të duhura drejt tregut dhe pas shkollimit ta kenë më të lehtë punësimin.



## Zhvillimi dhe ofrimi i arsimit dual

Si Agjenci, bashkë me qendrat e kompetencës, jemi pjesë e procesit të hartimit të kurikulave të sistemit dual të arsimit në Kosovë. Ky proces ka filluar këtë vit si objektivë e MASHTI-it, me përkrahje të partnerëve zhvillimorë, për të ofruar arsim cilësor dhe të zbatueshëm me nevojat e tregut të punës.

Sistemi i arsimit dual është një model i arsimit që kombinon mësimin teorik në shkollë me aftësimin praktik në kompani. Ky sistem kërkon bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve arsimore dhe industrisë, si dhe përkushtim për të siguruar që nxënësit të kenë një përvojë të pasur dhe të vlefshme në të dy ambientet.

Ky model është i njohur për t'i përgatitur nxënësit për tregun e punës dhe për t'u siguruar që ata zhvillojnë aftësitë dhe përvojën praktike të kërkuara nga punëdhënësit.



## **Implementimi i mësimit dual në drejtime të ndryshme në qendrat e kompetencës**

Vazhdon implementimi i arsimit dual në klasat e 10-ta në profilet: Automekanik, Floktari, Estetikë dhe Murator në Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë dhe QK-të në Prizren. Tanimë mësimi dual aplikohet në 12 profile në shkollat e AAP-së në Kosovë.





## **Konferenca për Arsimin e të Rriturve**

Është mbajtur konferenca me titull “Promovimi i Arsimit për të Rritur (ARr) në Kosovë“, organizuar nga ALE NK-a.

Qëllimi i themelimit të “Rrjetit për arsim dhe aftësim të të rriturve në Kosovë (ang.: Adult Learning and Education Network in Kosovo - ALE NK-a) është që ta nxisë bashkëpunimin efektiv në mes të ministrive relevante si dhe të ofruesve publikë dhe jopublikë për çështjet e ARr, po ashtu ta institucionalizojë rolin ndërsektorial të ARr në fushën e mësimit gjatë gjithë jetës në Kosovë.

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur është anëtar i rrjetit të Arsimit për të Rritur ALENK. Në këtë konferencë z. Muhamer Ibriqi ka përfaqësuar AAAPARr-në, duke paraqitur punën dhe aktivitetet e Agjencisë që ndërlidhen me komponentët e Arsimit për të Rritur.



## Punëtorja e organizuar nga AAAPARr dhe DVV International

“Prezantimi i draft-programit afatshkurtër (modular) të arsimit për të rritur në TIK”.

Znj. Fikrije Zymberi, drejtoreshë nga AAAPARr, theksoi rëndësinë e kurseve afatshkurtra për arsimin e të rriturve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, se si iniciativë duhet filluar të zbatohet në vitin e ardhshëm shkollor dhe duhet promovuar si pako e kualifikimeve në kuadër të dyerve të hapura, dhe Z. Ramadan Alija - udhëheqës i organizatës DVV International në Kosovë, i cili potencoi se vitin tjetër është paraparë të hapet një qendër për aftësim për të rritur në Prizren sipas modelit popullor të shkollave gjermane ku do të realizohen kurse afatshkurtra, po ashtu përmendi edhe rrjetin ALENKA të themeluar në bashkëpunim me MASHTI-n. Pastaj u bë shpalosja e draft-programit afatshkurtër (modular) të arsimit për të rritur në TIK nga Muzafer Ademaj & Enes Vezaj. Profesor Ademaj gjatë shpalosjes ceku se kursi afatshkurtër është hartuar që të zhvillohet në 6 module me 320 orë dhe me 16 kredi.



## Ofrimi i kualifikimit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta”

Ka filluar mësimin gjenerata e gjashtë e asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta me gjithsej 64 kandidatë të regjistruar në dy regjione, në Gjilan dhe Gjakovë.

Si institucione kemi mbështetur zhvillimin e kualifikimit të nivelit pesë për asistentë të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (NVA), për të siguruar një trajtim të barabartë dhe për të ofruar arsim dhe aftësim profesional gjithëpërfshirës.

Standardi i profesionit për këtë kualifikim është zhvilluar nga ekspertët vendorë, ndërsa zhvillimin e kurrikulës, materialeve mësimore dhe trajnimin e mësimeve të arsimdhënësve e ka realizuar Projekti LuxDev në kuadër të partneritetit publik-privat me një kompani të njohur ndërkombëtare, Pearson.

Kualifikimi për nivelin e pestë në këtë nivel aktualisht ofrohet në 7 institucione arsimore, me 181 kandidatë të regjistruar në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren dhe në Ferizaj. Deri më tani kanë diplomuar gjithsej 234 kandidatë.





## **Rekrutimi i kandidatëve në kualifikimin e nivelit të pestë, AFNVA**

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPAR) ka zhvilluar provimin pranues për kandidatët që aspirojnë të bëhen asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Kjo ngjarje bashkon 225 individë të përkushtuar nga rajoni i Gjakovës dhe Gjilanit, të gjithë të përkushtuar për një ndikim pozitiv në jetën e këtyre nxënësve të rinj të jashtëzakonshëm.



## **Diplomimi i gjeneratës së katërt të “Asistentëve për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”**

Është mbajtur ceremonia e diplomimit të gjeneratës së katërt të "Asistentëve për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta arsimore", të cilët e kanë përfunduar me sukses kualifikimin. Ky kualifikim është një storie e suksesit në ofrimin, zbatimin, cilësinë dhe punësimin e asistentëve falë bashkëpunimit dhe përkushtimit të MASHTI-t, AAAPARr-së dhe aktorëve të tjerë, me qëllim të ofrimit të shërbimeve kategorive të ndjeshme të fëmijëve dhe nxënësve, duke nxitur kështu gjithëpërfshirjen dhe ngritjen e standardeve në ofrimin e shërbimeve për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta.



## Zhvillimi dhe ofrimi i kurseve afatshkurtra modulare

Në bashkëpunim me DVV-International, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur ka mbajtur punëtorinë për zhvillimin e tri programeve afatshkurtra modulare në arsimin për të rritur, në profilin e Instaluesit elektrik, Muratorit dhe TIK-ut. Ofrimi i programeve afatshkurtra modulare në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional është një mundësi e mirë për të ofruar programe të tilla të cilat janë mjaft të kërkuara nga individët dhe grupet e caktuara për t'i përmbushur kërkesat e tregut të punës.



## **Nënshkrimi i marrëveshjes me OJQ-në “KOSHA” për realizimin e trajnimit për siguri dhe shëndet në qendrat e kompetencës**

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim të të Rriturve në shkurt të vitit 2023 ka lidhur kontratë për shërbim publik me Shoqatën Kosovare për Siguri dhe Shëndet në Punë (KOSHA) për “Rritjen e kapaciteteve për siguri dhe shëndet në punë për stafin e Agjencisë, stafin dhe nxënësit e gjashtë shkollave profesionale - qendrave të kompetencës për mbajtjen e trajnimeve lidhur me:

Organizimin dhe menaxhimin e sigurisë në punë

- Shkaqet e aksidenteve në punë
- Puna në lartësi,
- Gërmimet,
- Hapësirat e mbyllura,
- Makinaria,
- Elektriciteti,
- Pajisjet personale mbrojtëse.

Bazat e zjarrit

- Vlerësimi i rrezikut nga zjarri
- Shuarja e zjarrit
- Pajisjet për shuarjen e zjarrit
- Procedura e evakuimit nga zjarri
- Mbikëqyrësit e zjarrit
- Stërvitje në rast zjarri
- Plani emergjent.

Nga trajnimi i zhvilluar nxënësit kanë arritur të identifikojnë disa rreziqe që ekzistojnë në vendin e punës dhe të parashikojnë dëmet që ato mund të shkaktojnë. Ata i kanë kuptuar mjaft mirë dallimet midis kategorive të ndryshme të rreziqeve në punë, identifikimin e mënyrave për të shmangur ato rreziqe, kanë sqaruar se disa rreziqe në punë janë të dukshme, ndërsa disa jo. Ata janë në gjendje t’i analizojnë dhe renditin rreziqet për sa i përket dëmit/lëndimit të mundshëm dhe shtrirjes së lëndimit.

Ata kanë mësuar se punëtorët e rinj kanë më shumë gjasa se të rriturit të lëndohen në punë dhe se ekzistojnë rregulla të veçanta për mbrojtjen e të rinjve-mbrojtje e veçantë, veçanërisht në cilat vende pune nuk lejohet të punojnë, por edhe për kohën dhe orët e punës.



## Nënshkrimi i marrëveshjes me “Yllirian Sh. P. K.” për zbatimin e platformës së e-shkollorit në shkollat partnere të AAAPARr-së

Për qendrat e kompetencës është realizuar punëtorja për prezantimin e platformës elektronike "e-shkollori", me qëllim që shumë shërbime dhe aktivitete që realizohen në shkolla, të digjitalizohen dhe të optimalizohen duke ndikuar në performancë dhe sigurim të cilësisë në arsim.

Digjitalizimi në shkollë-arsim, si pjesë e “Strategjisë së Arsimit në Kosovë”, është komponentë e rëndësishme për t’iu përgjigjur kërkesave të zhvillimit teknologjik të hovshëm dhe pajisjes së nxënësve me kompetencat e duhura teknologjike - digjitale. Në këtë platformë janë në dispozicion të dhënat për klasë dhe suksese të nxënësve, ku mund të kenë qasje edhe prindërit për ta përcjellë suksesin e fëmijëve përkatësisht prej vijueshmërisë së tyre në shkolla.



## “Dyert e hapura” në qendrat e kompetencës

Janë mbajtur ditët e “Dyerve të hapura”. Me këtë rast është paraqitur puna në kabinete për secilin profil në qendrat e kompetencës.

Qendrat e kompetencës kanë mbajtur aktivitetin tradicional "Dyert e hapura", me ç'rast janë paraqitur të arriturat e nxënësve në të gjitha drejtimet profesionale të këtyre qendrave.

“Dyert e hapura” nëpër qendrat e kompetencës



---

## **Vizitat, konferencat dhe takimet jashtë vendit**

### **Lëvizshmëria e nxënësve në Itali në kuadër të projektit “MoVET”**

Është realizuar mobiliteti/lëvizshmëria dyjavore e grupit të parë të nxënësve në Itali ndërmjet datave 04.09.2023-15.09.2023. 13 nxënës nga katër qendra të kompetencës kanë qenë në Trieste të Italisë. Në Trieste kanë marrë pjesë nxënësit nga QK - Prizren, QK “11 Marsi” - Prizren, QK “Shtjefën Gjeçovi” - Prishtinë dhe QK “Kujtim Krasniqi” - Malishevë. Grupi i nxënësve është shoqëruar nga mësimdhënësi Jetmir Berisha, i cili ka marrë pjesë aktive në projekt që nga fillimi i vitit 2021 në mobilitetin e stafit (JST) nga ana e AAAPARr-së dhe QK-ve. Vizita studimore për grupin e parë të nxënësve është organizuar në Trieste, në selinë e partnerit kryesor të projektit “MoVET”, përkatësisht organizatës EnAIP nga Italia dhe ka përfshirë një program vizitash dhe aktiviteteve kushtuar sektorëve të arsimit profesional TIK, turizmit dhe logjistikës. Janë vizituar hapësirat e qendrës së ENAIP në Trieste ku nxënësit kanë marrë gjithashtu informacione edhe për shtrirjen e organizatës në qytete të tjera. Përmes sesioneve informuese nxënësit kanë pasur rastin t’i shkëmbejnë përvojat e tyre edhe me nxënësit dhe mësimdhënësit.



Gjatë periudhës së qëndrimit në Trieste/Itali, nxënësit kanë vizituar: URBAN CENTER (Fab Lab, një laborator i fabrikuar në shërbim të të gjithë komunitetit me të gjitha pajisjet moderne bashkëkohore për ICT); Accademia Nautica dell’Adriatica CVET – EQF 5, një qendër për ofrimin e kurseve të nivelit të pestë të kualifikimeve, me fokus në drejtimin e Transportit/Logjistikës, duke përfshirë edhe ICT-në. Janë paraqitur projektet “COME IN”, pastaj programi “INTERREG EUROPE” në hapësirat e qendrës së ENAIP. Vizitë në qytetin e Triestes, vende dhe ndërtesa karakteristike, “Parco di San Giovanni”. Vizitë në “AREA SCIENCE



PARK”, “Port of Trieste”, takime disaditore në shkollën e ENAIP.

## **Lëvizshmëria e nxënësve në Bruksel**

- Në kudër të projektit MoVET-ENAIP në Belgjikë, ndërmjet datave 20.11.2023-03.12.2023, kanë marrë pjesë 12 nxënës nga QK - Prizren, QK “11 Marsi” - Prizren, QK “Shtjefën Gjeçovi” - Prishtinë dhe nga QK “Kujtim Krasniqi” - Malishevë për të realizuar vizitë studimore.

Ministrja Nagavci i priti nxënësit e grupit të dytë para realizimit të vizitës studimore dhe me këtë rast i uroi ata ta shijojnë këtë përvojë dhe të përfitojnë njohuri nga vizita dyjavore në Belgjikë, ndërsa njohuritë e fituara t'i zbatojnë në Kosovë. “Uroj të ketë sa më shumë nxënës të cilët përfitojnë përvoja të tilla, të realizohen ëndrrat e tyre dhe me përvojat e fituara të kontribuojnë në vendin tonë”.



---

Gjatë vizitës në Belgjikë janë organizuar punëtori dhe vizita të ndryshme. Përveçse ka pasur diskutime në lidhje me kurrikulat e sistemeve elektromekanike dhe të energjisë së ripërtëritshme dhe vizita në SITCA - Qendra Simulative Trajnuese për kujdesin mjekësor, gjithashtu nxënësit patën rastin të marrin pjesë në panele diskutimi përmes punëtorive të organizuara nga organizata pritëse ODISEE, sikurse në punëtorinë e programimit, në punëtorinë kulturore dhe gjuhësore me studentët nga Odisee, pjesëmarrje në ligjërata të ndryshme dhe vizita nëpër kabinete.



## Vizitë në Maltë

Vizitë institucioneve relevante të arsimit dhe aftësisht profesional në Malta, e organizuar dhe financuar nga Projekti ALLED 2, me qëllim të marrjes së përvojave më të mira për avancimin e sistemit arsimor/profesional në vendin tonë. Pjesë e kësaj vizite ishte edhe drejtoresha e AAAPARR, znj. Fikrije Zymberi.

Gjatë kësaj vizite janë vizituar:

MCAST (Kolegji për Arte, Shkencë dhe Teknologji), Instituti i Turizmit - ITS, Universiteti i Maltës, Autoriteti i Arsimit të Mëtejshëm dhe i Lartë në Maltë (MFHEA), Instituti i Agrikulturës,

Peshkimit dhe Mirëqenies së Kafshëve.

Rekomandimet:

Kosova të ndërtojë një sistem fleksibil të AAP-së që u përshtatet nevojave dhe kërkesave të nxënësve/studentëve/kandidatëve.

Bazuar në përvojat e marra nga funksionimi i institucioneve të Maltës, nevojitet ristrukturimi i agjencive ekzistuese në shtetin tonë për një funksionim të duhur të sistemit të AAP-së, pasi nuk ka funksionim të duhur të sistemit të sigurimit të cilësisë së kualifikimeve në KKK, gjithashtu të qartësohen rolet e secilit mekanizëm brenda sistemit të arsimit dhe aftësisimit profesional, si në nivelin qendror, po ashtu edhe në nivelin lokal.



## Vizitë pune në Shqipëri

Në kuadër të takimeve me institucionet relevante të arsimit në Shqipëri, vizituam dhe Kolegjin Profesional të Tiranës. Ky kolegji ofron kualifikime profesionale dhe të nivelit të pestë, për këtë arsye biseduam dhe ndamë përvojat tona me stafin e këtij institucioni arsimor, duke parë mundësitë e bashkëpunimit për ofrimin e kualifikimeve të nivelit të pestë.



## Punëtorja në Shqipëri (zbatimi i mësimit dual në IAAP)

Pjesëmarrja në punëtorinë e organizuar nga MASHTI për zbatimin e mësimit dual në shkollat e arsimit dhe aftësimin profesional, integrimi i teorisë dhe praktikës, ndërlidhja e shkollës me kompanitë, mënyra e evidentimit të nxënësve, monitorimi, vlerësimi e shumë komponentë të tjerë që ndikojnë në realizimin e mësimit dual. Ky koncept synon të bëjë ndërlidhjen më të fortë dhe efikase të shkollës me biznesin, duke ndikuar në përgatitjen e duhur të nxënësve për tregun e punës.



## Pjesëmarrja në simpoziumin e EVTA-s në Selanik - Greqi

Në mesin e shumë vendeve të Evropës, ishim pjesëmarrës në simpoziumin vjetor të organizuar nga Asociacioni Evropian i Formimit Profesional EVTA në Selanik të Greqisë.

Në qendër të diskutimeve ishin tema të rëndësishme të ndërlidhjes së shkathtësive të fuqisë punëtore me tregun e punës.

Ishte mundësi e mirë për t'i parë dhe për t'u informuar për zhvillimet e fundit në parashikimin e aftësive, si: digjitalizimi, agjenda e gjelbër, sektori i automobilave në kohën e elektrifikimit, lidhjes dhe inteligjencës artificiale dhe komponentë të tjerë që ndikojnë në përshtatjen e shkathtësive dhe kompetencave të duhura të të rinjve tanë me kërkesat e tregut të punës, duke ndikuar në fuqizimin e ofruesve të arsimit dhe aftësimin profesional, observimin e politikave të reja fuqizuese dhe eksplorimin e mundësive për ndërkombëtarizim dhe dobi sociale.



## **Vizitat/takimet e realizuara nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur në bashkëpunim me Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGjK) në Qendrat e Kompetencës**

Në kuadër të aktiviteteve, me qëllim të identifikimit të bizneseve për bashkëpunim për realizimin e praktikës profesionale në qendrat e kompetencës, në menaxhimin e AAAPARr-së, është realizuar “Java e Edukimit Profesional 20-24 nëntor 2023”.

Ky aktivitet është realizuar në bashkëpunim me Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe ka qenë një mundësi e mirë e shtimit të bashkëpunimit ndërmjet qendrave të kompetencës, bizneseve anëtare të OEGjK-së dhe institucioneve të arsimit profesional.

Java e Edukimit Profesional ka filluar në Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, ku përfaqësuesit e AAAPARr-së, Muhamer Ibriqi dhe Tringa Prekorogja, së bashku me anëtarët e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, të prirë nga Besarta Hyseni dhe Eriola Muhaxhiri, kanë takuar menaxhmentin e shkollës dhe nxënësit.



Qendra e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë dhe “11 Marsi” në Prizren



Kryesuesi i Kllasterit për edukim profesional në OEGjK z. Bedri Xhafa, theksoi rëndësinë e implementimit të sistemit dual të arsimit, kurse z. Fatos Dida nga kompania Proton Cable ndau përvojat dhe përfitimet e aftësisimit të nxënësve në kompaninë e tij. Sikur edhe në shkollat e tjera të vizituara gjatë kësaj jave, edhe në QK “11 Marsi” në Prizren, z. Bedri Xhafa nga APPK dhe z. Fatos Dida nga Proton Cable, të prirë nga drejtoresha e OEGjK, Nora Hasani, kishin mundësinë ta shikonin nga afër punën e nxënësve nga drejtime të ndryshme, në veçanti profilin “Metalpunues” i cili zhvillohet sipas sistemit të arsimit dual.

Gjatë takimit edhe nxënësit patën rastin t’i tregojnë përvojat e tyre në kompani si dhe sfidat në realizimin e praktikës profesionale. Ata, po ashtu, patën rastin t’i bëjnë pyetjet e tyre rreth përfitimeve nga aftësimi në kompani, punësimi dhe vetëpunësimi i tyre pas përfundimit të shkollimit.



## Konferenca me EVBB (Shoqata Evropiane e InSTITUTEVE për Aftësimin Profesional me seli në Bruksel) për “Erasmus+ mundësitë për Kosovën për t’i përmirësuar njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat në fushën e AAP”

Të lumtur që na është bashkuar jo vetëm si bashkorganizator, por edhe na ka nderuar me praninë e tij në Prishtinë, sekretari i përgjithshëm i Shoqatës Evropiane të InSTITUTEVE për Aftësimin Profesional, z. Theodor Grassos shpалosi mundësitë e financimit (udhëzim për Erasmus+ ) dhe njohuritë për thirrjet që përfshijnë AAP. Të pranishëm ishin: EVBB nga Brukseli, AKMI nga Greqia, MASHTI, Zyra e BE-së në Kosovë, Zyra e GIZ-it në Kosovë, Agjencia Austriake për Zhvillim- ALLED 2, Projekti-Luxdev, DVV-International, APPK, IBCM- Mitrovica, KEC (Qendra e Kosovës për Arsim), Kolegji Universum, disa shkolla profesionale nga e mbarë Kosova, nxënësit Natyra Zejna nga Ferizaj, Trim Gota, Januz Kabashi, Endrit Hoti nga QK “11 Marsi” - Prizren dhe Erida Beqiri nga QK “Shtjefën Gjeçovi” - Prishtinë si dhe mësime dhënësit (shoqërues) Jetmir Berisha dhe Bashkim Hyseni treguan përvojat e tyre gjatë lëvizshmërive në kuadër të projekteve të shkëmbimeve regjionale të nxënësve nga projekti i RYCO-së (Regional Youth Cooperation Office) dhe lëvizshmërive (mobiliteteve) në Itali dhe Finlandë përmes projekteve MoVET (Mobility for VET in Europe, sq.: Lëvizshmëria për AAP në Evropë) dhe V2V (Pilot VET mobility scheme for the Western Balkans, sq.: Skema pilot e mobilitetit të AAP-së për Ballkanin Perëndimor).



## WEBINARET - takimet online

### **“Tejkalimi i pengesave për të rinjtë në mësimin e bazuar në punë dhe praktikat jashtë vendit: praktikat premtuese nga ALMA dhe Erasmus”**

ALMA (Aim-Qëllimi, Learn-Të mësuarit, Master-Përfeksionimi, Achieve-Arritja), një iniciativë e re brenda Fondit Social Evropian Plus (ESF+) dhe paraardhësi i saj, Lëvizshmëria TLN1, kanë gjetur mënyra efektive për t'u mundësuar NEET (Rjete)-ve të zhvillojnë aftësi të reja dhe kompetenca personale përmes mbështetjes së përvojave të lidhura me punën jashtë vendit. Në të njëjtën mënyrë, programi Erasmus+ gjithashtu ka fituar mjaftueshëm përvojë ndër vite se si t'u shërbejë më mirë nevojave të praktikantëve, kompanive dhe ofruesve të AFP-së në organizim të lëvizshmëri. Si mundën këto dy fonde financimi për lëvizshmëri, të cilat të dyja kanë në zemër mësimin e bazuar në punë të përdoren më mirë nga pikëpamja e ofruesve të trajnimit dhe kompanive? Si e plotësojnë njëra-tjetrën? Çfarë zgjidhje kanë projektet brenda këtyre programeve për t'i bindur të rinjtë dhe kompanitë për përfitimet duke punuar përkohësisht jashtë vendit, për t'i tejkaluar barrierat gjuhësore dhe kulturore, për ta garantuar sigurinë dhe mirëqenien jashtë vendit, dhe sfida të ngjashme? ESF+ ofron mbështetje aty ku është e nevojshme, me fokus te njerëzit e marginalizuar.

### **“Puna lidhur me adresimin e sfidave në fushën e kompetencave digjitale (Digicomp) Hack4Society ‘Hackathon’”**



Fushat e Kompetencës - DigComp

## FUSHA 2 KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI

### 2.1 Ndërveprimi përmes teknologjive digjitale

### 2.4 Bashkëpunimi nëpërmjet teknologjive digjitale

## FUSHA 3 KRIJIMI I PËRMBAJTJES DIGJITALE

### 3.1 Zhvillimi i përmbajtjes digjitale



### Aplikacioni SafeNET

## FUSHA 5 ZGJIDHJA E PROBLEMIT NË MJEDISIN DIGJITAL

### Mënyrat për ta përmirësuar përvojën mësimore dhe efektivitetin e mësimit në distancë të AFP-së

Është i nevojshëm një trajnim për profesionistët e AFP-së për të përdorur platforma të ndryshme digjitale të të mësuarit/mësimdhënies, kategoritë, vetëreflektimi për mësimdhënie, aftësia për ta menaxhuar pjesëmarrjen, përshtatshmërinë për detyrë.

**Grupi i synuar** - Mësimdhënësit dhe profesionistët e AFP-së të të gjitha grupmoshave, me prejardhje të ndryshme socio-ekonomike.

#### **Përparësitë:**

Rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me stilet e mësimdhënies dhe mënyrat që pjesëmarrësit të ndërveprojnë në një mjedis kursi në grup.

Aplikacion i përshtatshëm për grupe të ndryshme (klasa shkollore, seminare, takime të ekipit, kompani.)

Kosto-efektive për zgjedhjen e një platforme që është e përballueshme për profesionistin ose kompaninë e caktuar.

Rritja e shkrim-leximit digjital në lidhje me edukimin në internet dhe mjetet e bashkëpunimit. Zgjidhje të realizueshme/të përballueshme në lidhje me mjedisin mësimor.

#### **Dobësitë:**

Mund të jetë e tepërt, pjesëmarrësit me nevoja të veçanta mund të mos akomodohen dhe algoritmi duhet të funksionojë pa të meta.



## Aplikacioni DIG-E-FEM


Aplikacion për femra (të marginalizuara dhe me arsimim të ulët), vajza të reja! Femrat që duan të fitojnë në mënyrë digjitale, por nuk janë të vetëdijshme për botën moderne dhe bizneset e reja digjitale, dhe që përballen me vështirësi në marrjen e arsimit në shoqëritë dhe kulturat e tyre të cilat nuk i mbështesin arsimimin dhe fuqizimin e tyre.

## “Zhvillimi i shkathtësive digjitale : drejt iniciativave të matshme dhe të qëndrueshme”

Fondacioni Evropian i Trajnimit i bashkoi forcat me Grupin Ndërkombëtar - Taskforcën e Mësimdhënësve për Edukim 2030 për t'ua paraqitur edukatorëve të interesuar – mësimdhënësve, trajnerëve, mentorëve, drejtuesve të shkollave – si dhe studiuesve dhe politikëbërësve, mjetet origjinale të zhvilluara nga të dy organizatat për t'i mbështetur praktikat e reja të mësimdhënies dhe të nxënies dhe për ta inkurajuar potencialin krijues të mësimdhënësve.

U ndanë burime dhe mjete të reja që mund të përdoren për t'i hartuar përvojat e të nxëniet të nxënësve dhe për mësimdhënësit që të eksperimentojnë me qasjet më të fundit në metodologjinë e mësimdhënies, vlerësimit dhe zhvillimit profesional. Ne, gjithashtu, do t'i paraqesim gjetjet e para nga hulumtimi i fundit i ETF-së mbi mundësitë dhe barrierat për inovacionin në arsim.

Webinari ofroi, gjithashtu, hapësirë për pjesëmarrësit që të dëgjohen nevojat e tyre në drejtim të mbështetjes inovative të mësimdhënies dhe ofroi mundësi për mbledhje të ideve për zhvillimin e mjeteve të reja që janë në përputhje me nevojat e edukatorëve në kontekste të ndryshme.



## Webinar: “Udhëzues për Programin Erasmus+ 2024 dhe thirrje për propozime”

EACEA-EPLUS-CBHE@ec.europa.eu


### Përshtatshmëria

Çdo organ publik ose privat aktiv në fushat e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit mund të aplikojë për financim në kuadër të programit Erasmus+. Për më tepër, grupet e të rinjve që janë aktivë në punën me të rinjtë, por jo domosdoshmërisht në kontekstin e një organizate rinore, mund të aplikojnë për financim për lëvizshmërinë e të rinjve dhe punonjësve për të rinjtë për të mësuar, aktivitetet e pjesëmarrjes së të rinjve dhe veprimet e përfshirjes DiscoverEU (Zbuloni Evropën).

### Buxheti dhe kohëzgjatja e projekteve

Buxheti i përgjithshëm i caktuar për këtë thirrje për propozime është vlerësuar në 3 681,76 milionë euro:

Arsimi dhe trajnime:	EURO	3 256,61 milionë
Rinia:	EURO	336,28 milionë
Sporti:	EURO	63,12 milionë
Jean Monnet:	EURO	25,75 milionë




## “Aktivitetet e të mësuarit nga bashkëmoshatarët e organizuar nga EVBB në kuadër të grantit operacional META VET”

Aktivitetet e të mësuarit nga kolegët e EVBB-së ku ishin projektuar në mënyrë të menduar për të përfruar me vizionin më të gjerë të Zonës Evropiane të Arsimit (EEA), duke synuar arritjen e një grupi të larmishëm objektivash.

Faza e parë: Webinari i ndarjes së njohurive: Faza jonë fillestare përmbante webinarë paralelë të planifikuar. Çdo sesion fokusohet në tema specifike të zgjedhura nga grupe individuale të bashkëmoshatarëve.

Faza e dytë: Webinari i Angazhimit Bashkëpunues dhe Planifikimit të së Ardhmes: Në vijim është vazhduar qasja paralele e uebinarit me sesione që synojnë angazhimin bashkëpunues dhe planifikimin e ardhshëm.



# 1. SEKTORI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

## 1.1. Qeverisja dhe legjislacioni

### 1.1.1. Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Burimeve Njerëzore

Përgatitja e planit të personelit sipas kërkesave të MPB-DMZP për vitin 2023.

Përgatitja e planit për trajnimin e stafit të AAAPARr-së nga IKAP për vitin 2023.

Vlerësimet vjetore për performancën e menaxhmentit të shkollave partnere të AAAPARr-së për vitin 2023.

Vlerësimet vjetore për stafin e Agjencisë së AAAPARr-së për vitin 2023.

Shpallja e konkursit dhe zhvillimi i procedurave sipas kërkesave të menaxhmentit për plotësim të vendeve të punës për mësimdhënës dhe staf teknik në qendrat e kompetencës në “11 Marsi” në Prizren, QeK në Skenderaj, QeK “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, QeK Ferizaj, QeK Prizren dhe QeK Malishevë.

Shpallja e konkurseve dhe zhvillimi i procedurave të rekrutimit sipas Udhëzimit Administrativ të MASHTI-t nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, për tri qendrat e kompetencës: Qendra e Kompetencës në Prizren, Qendra e Kompetencës në Malishevë dhe Qendra e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë.

Përgatitja e kontratave të reja për mësimdhënësit e qendrave të kompetencës si dhe vazhdimi i tyre në bazë të nevojave të shkollave.

Përgatitja dhe procedimi i ndryshimeve në baza mujore për listën e pagave për stafin e shkollave partnere, sipas kërkesave të shkollave partnere, si dhe stafin e Agjencisë.

Përditësimi i të dhënave për stafin e Agjencisë dhe shkollat në menaxhimin e agjencisë.

Përgatitjet për fillimin e regjistrimit të nxënësve për vitin shkollor 2023/2024 për nivelin IV të arsimit sipas KKK.

Përgatitjet për fillimin e regjistrimit të nxënësve për vitin shkollor 2023/2024 për “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta” për nivelin e pestë të arsimit sipas KKK, grupi 6.

Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor për nivelin e pestë.

Përgatitja e kontratave të reja për mësimdhënësit e nivelit të pestë.

Përgatitja dhe dërgimi i kërkesave për trajnim të zyrtarëve në Sistemin e Free Balance dhe nga



IKAP për stafin e Agjencisë dhe shkollave partnere.

Regjistrimi i zyrtarëve në platformën elektronike për deklarimin elektronik të pasurisë sipas udhëzimeve të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Përgatitja e lëndëve për auditim nga Auditori i Përgjithshëm.

Publikimet e konkurseve për arsimin e të rriturve për shkollat partnere.

Shkresat për gjykatat dhe Inspektoratin e Punës lidhur me pagesën e shujtave dhe pagesën e udhëtimeve, si dhe pagesat e tjera në bazë të kontratës kolektive për mësimdhënësit e shkollave partnere.

Shkresa për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit lidhur me kërkesat për lejimin dhe buxhetimin e disa kategorive ekonomike.

Kërkesat për përfaqësim ligjore nga Avokatura Shtetërore për lëndët që kanë të bëjnë me pagesën e shujtave dhe pagesën e udhëtimeve për mësimdhënësit e shkollave partnere.

Përgatitja e ankesave drejtuar shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës dhe përmbauesve privatë lidhur me pagesat e shujtave dhe udhëtimit për mësimdhënësit e shkollave partnere.

Takim me menaxhmentin e shkollave partnere të Agjencisë së AAPARr-së lidhur me çështjet e personelit dhe financave.

Takime të rregullta me administratorët e shkollave partnere të Agjencisë së AAPARr-së për çështjet e personelit dhe financave.

Përgatitja e vendimeve për pushim të lehonisë, vendimet për pensionime, vendimet për angazhim, vendimet për komisionet përzgjedhëse, vendimet për pagesa, vendimet për pezullim të vendit të punës, vendimet për pushim pa pagesë, vendimet për komisione për ankesa si dhe vendime të tjera.

Përgatitja e statistikave të rregullta për numrin e punëtorëve, për kualifikimet, ndryshimet e muajit dhe konkurset.

Aprovimi i lëndëve në sistem lidhur me procedimin e pagesave të shollave dhe Agjencisë.

Procedimi i pagesave për arsimin e të rriturve si dhe kërkesa për rritjen e kufijve për këtë kategori buxhetore.

Përgatitja e formularëve dhe procedurës së vlerësimit për konkurset e shpallura për rekrutimin e stafit për shkollat partnere të Agjencisë.

Procedimi i kërkesës të QeK-ve për hapjen e profileve të reja.

Përgjigjet në kërkesat e ndryshme të mësimdhënësve të shkollave partnere.

Përgatitja e kërkesave për mbështetje për Ministrinë e Financave.

Planifikimi i kufijve buxhetorë për Agjencinë dhe shkollat partnere.

Pjesëmarrja në komisione të ndryshme gjatë vitit.

Pjesëmarrja në punëtori të ndryshme gjatë vitit.

Pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga IKAP, Thesari, Agjencia Antikorrupsion dhe FSLA. Pjesëmarrja në trajnimin nga IKAP “Etika në administratën publike - parandalimi i konfliktit të interesit dhe korrupsionit”;

Përgatitja e raporteve mujore, gjashtëmujore dhe vjetore të punës.

### **1.1.2. Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Financave**

Të bashkangjitur më poshtë gjeni listën e aktiviteteve kryesore që janë realizuar nga Zyra e Financave për periudhën janar - dhjetor 2023, ku është punuar me intensitet të lartë.

Më poshtë gjeni aktivitetet:

- Dërgimi i kufijve buxhetorë të qendrave të kompetencës për planifikimin e buxhetit 2023-2025;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për Agjenci dhe 6 qendra të kompetencës për vitin 2024-26;
- Përpilimi i pasqyrave financiare për AAAPARr dhe QeK për vitin 2022, si dhe dërgimi tek organet kompetente;
- Dërgimi email shkollave për përgatitjen dhe planifikimin e buxhetit, planifikimin e prokurimit dhe kesh planet për një vit fiskal sa më efikas;
- Pranimi i planifikimit të prokurimit nga të gjitha shkollat si dhe planifikimi i buxhetit për vitin 2023-25;
- Dërgimi i planifikimit të të hyrave vetjake të shkollave në MASh dhe MF;
- Menaxhimi dhe përditësimi i të dhënave (inkorporimi i të dhënave në sistem) për planin e zotimit dhe shpenzimit për kategoritë ekonomike mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe shpenzime kapitale për Agjencinë dhe 6 (gjashtë) QeK në menaxhimin tonë në sistemin e ri për planifikimin dhe menaxhimin e rrjedhës së parasë për vitin 2023;

- Përgatitja dhe dërgimi i lëndëve të kërkuara nga Auditori i Jashtëm për periudhën shtator- dhjetor 2022 si dhe janar-mars 2023, po ashtu kontakti i vazhdueshëm me auditorët për mostra e kërkuara, dërgimi i emailave;
- Njoftim lidhur me dorëzimin e raportit vjetor për sinjalizim më së voni deri më 31 janar 2023(dërgim i raportit në Agjencinë Kundër Korrupsionit);
- Marrja pjesë në trajnimin e mbajtur në IKAP për: *Sinjalizuesit*;
- *Avancim* i stafit të zyrës së financave për trajnimin e organizuar dhe mbajtur në IKAP për ***Ekzekutimin e buxhetit dhe procedurat financiare gjatë vitit 2023***;
- *Pjesëmarrja* në punëtorinë lidhur me planifikimin e planit të parasë së gatshme (keshit) - niveli qendror - organizuar nga Ministria e Financave;
- Përgatitja me të dhënat e punëtorëve për pasqyrat financiare për vitin 2022;
- Fletëdeponimi i nënshkrimeve të zyrtarëve të autorizuar dhe atyre të angazhuar në sistemin SIMFK për vitin 2023;
- Pranimi i kesh planeve të gjashtë qendrave të kompetencës si dhe dërgimi i tij në MASHTI;
- Raportimi i obligimeve të papaguara - obligimet dhe obligimet kontraktuale të krijuara nga nënprogramet buxhetore në kuadër të MASHTI-t për periudhën janar-dhjetor 2022;
- Kërkesë lidhur me raportimin e obligimeve të papaguara - obligimet dhe obligimet kontraktuale të krijuara nga nën programet buxhetore në kuadër të MASHTI-t për periudhën shkurt 2022;
- Regjistrimi i pasurisë nën vlerën 1 000 euro për gjashtë QeK dhe Agjencinë për vitin 2022, vendimet për regjistrimin e pasurisë, stoqeve dhe raportimi i tyre te MASHTI;
- Përpilimi i emailit dhe dërgimi i informatave financiare Komisionit Evropian lidhur me financimin e QeK-ve, si dhe dërgimi i emailit Ministrisë së Financave për Donacione dhe Grante në MF për marrjen e informatave financiare për donatorë;
- Kontakti i vazhdueshëm me zyrtarë të MF lidhur me projektet e shkollave, ecuria si shkon deri te derdhja e mjeteve;

- Grumbullimi i të hyrave nga ana e shkollave , komunikimi dhe dërgimi i raporteve të ndryshme te zyrtarët kompetentë në MASHT dhe MF;
- Zotimi i lëndëve (obligimeve) të vitit 2022 dhe obligimet e vitit aktual për shpenzime të krijuara nga qendrat e kompetencës dhe Agjencisë për Arsim Profesional si dhe procedimi i mëtutjeshëm;
- Përpilimi i emailit dhe kërkimi i të dhënave nga QeK për listën e inventarizimit të shkollave si dhe vendimet për komisionin mbikëqyrës të pasurisë. Kjo vjen si kërkesë e auditorit gjeneral;
- Përmbledhja dhe dërgimi i raporteve të pasurisë dhe inventarit të shkollave si dhe vendimi për komision për vlerësim të pasurisë për gjashtë qendrat e kompetencës dhe Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional auditorëve gjeneralë;
- Plotësimi i formularit (nënbuxhetimi) për buxhet shtesë në kategorinë mallra shërbime dhe paga mëditje si dhe dërgimi i tij në MF;
- Alokimi i të hyrave për qendrat e kompetencës në SIMFK - moduli për planifikim dhe menaxhim të rrjedhës së parasë;
  - Përgatitja e lëndëve, protokollimi dhe pranimi i lëndëve të shkollave në menaxhim;
- Procedimi i pagesave, duke përfshirë modulin e zotimit, aprovimit, urdhërblertes, pranimit të mallit, shpenzimit dhe certifikimit;
- Përgatitja e raportorit mujor, tremujor dhe gjashtëmujor të shpenzimeve dhe raportimi te zyrtarët kompetentë;
- Përgatitja e dokumenteve të ndryshme lidhur me marrëveshjet me projektet, takimet, komunikimet me ekzekutimin e buxhetit;
- Llogaritja e avancave, tërheqja e mjeteve dhe shpërndarja e tyre;
- Pranimi dhe kontrollimi i raportit të analizës së buxhetit për çdo muaj;
- Pranimi i listave të pagave për çdo muaj dhe analizimi i tyre;
- Pranimi i kërkesave për furnizime, shërbime dhe punë, duke përfshira analizën e buxhetit për mjetet të cilat mund të realizohen këto aktivitete;

- Pjesëmarrja në takimet online për projektin “**MoVET - Mobility for VET in Europe**” No EAC-2020-0863 që me fokus të veçantë është diskutuar mobiliteti i nxënësve dhe praktikat që do t’i marrin gjatë intershipit tremujor;
- Organizimi i Punëtorisë për Planifikimin i mirëfilltë i Buxhetit të Qendrave të Kompetencës për vitin 2024 -2026;
- Avancim i Zyrës së Financave në trajnimin lidhur me prezantimin e Planit Kontabël të Përditësuar dhe Udhëzuesit të Planit Kontabël;
- Përgatitja dhe dërgimi i të dhënave për projeksionet e të hyrave jotatimore 2024-2026;
- Avancimi i Zyrës së Financave në trajnimin në Turqi me temën: “Optimizmi dhe përmirësimi i proceseve të buxhetimit, prokurimit, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe sistemit të pagesave me fokus të veçantë në rrjedhshmërinë dhe performancën e tyre”;
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 2024\02;
- Hapja e sistemeve buxhetore për planifikim të shpenzimeve buxhetore 2024 2026; Bazuar në ndryshimin e Ligjit të Pagave, kemi bërë analizën, përgatitjen dhe futjen e të dhënave në sistemin e BDMS, duke përfshirë pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale dhe shpenzimet kapitale për të gjitha QeK-të dhe Agjencinë e AAAPARr-së;
- Transferimi i mjeteve buxhetore nga kategoria e shpenzimeve komunale në mallra dhe shërbime sipas rregullores në fuqi;
- Përgatitja e kërkesave shtesë me përmbylljen e vitit fiskal 2023 për të gjitha QeK-të;
  - Pjesëmarrja në punimet e Draft-Udhëzimit Administrativ për formulën e financimit për të gjitha institucionet e arsimit profesional në nivel komunal dhe qendror;
  - Analiza, përgatitja e lëndëve, regjistrimi në SIMFK i 15 nxënësve dhe profesorit përcjelljes për mbajtjen e trajnimit në ***Trieste-Itali*** më 04.09.2023-15.09.2023, për mobilitetin e nxënësve në kuadër të Projektit **MoVET - Mobility for VET in Europe**;

- Identifikimi dhe përgatitja e lëndëve të financave për auditorët e jashtëm-gjeneralë për periudhën janar-shator 2023 dhe për auditorë të brendshëm janar-shtator, dërgimi i tyre me email dhe kopje fizike;
- Analiza, përgatitja e lëndëve, regjistrimi në SIMFK i 15 nxënësve dhe profesorit përcjellës për mbajtjen e trajnimit në *Belgjikë-Bruksel* me datat 20.11.2023-03.12.2023, për mobilitetin e nxënësve në kuadër të Projektit **MoVET - Mobility for VET in Europe**;
- Përgatitja e lëndëve, regjistrimi i mësimdhënësve në SIMFK për marrjen e mjeteve për udhëtime zyrtare dhe kthimin e tyre prapë në bankë në kuadër të Projektit Vet to Vet që ka për qëllim përmirësimin e inovacioneve të praktikave dhe politikave të AAPARr-së;
- Planifikimi i buxhetit për vitet 2024-2026 si dhe përgatitja e tabelës së obligimeve vjetore të mbetura si pasojë e mungesës së buxhetit;
- Menaxhimi i disa kontratave për AAAPARr dhe qendrat e kompetencës, menaxhimi i listave të pagave dhe dërgimi i tyre në shkolla;
- Zgjidhja e çështjes dhe procedimi i pagesave të trajnerëve për programin kualifikues për “Këshilltarë në karrierë” për nivelin e katërt në Qendrën e Kompetencës në Prizren.



